

UDHËZIM
Nr.27, datë 18.8.2010

**PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.24, DATË 2.9.2008 "PËR
PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.24, datë 2.9.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Paragrafi i dytë i pikës 75/1.4, ndryshohet si më poshtë vijon:

"Në rast se tatimpaguesi në administratën tatimore rezulton me situatë kreditore të TVSH-së, e cila ka plotësuar kushtet ligjore për t'u rimbursuar dhe njëkohësisht në administratën doganore me situatë debitore për TVSH-në e shtyrë në import për makineri e pajisje me cikël të zhvillimit të investimit dhe fillimi i ofrimit të prodhimit apo shërbimit mbi 12 muaj, për të cilat është aplikuar skema e shtyrjes sipas përcaktimeve të sesionit I/I të vendimit nr.559, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave "Për skemën e shtyrjes së pagesës së TVSH-së, për makineritë dhe pajisjet e importuara, si dhe energjinë elektrike, të importuar nga KESH-sh.a., ka të drejtë të paraqesë kërkesë me shkrim pranë Ministrisë së Financave, në të cilën të kërkojë destinimin e shumës së TVSH-së së konfirmuar si të rimbursueshme nga organet tatimore, për likuidimin e shumës së TVSH-së debitore që ka në administratën doganore. Me paraqitjen e kërkesës nga tatimpaguesi, Ministria e Financave u kërkon informacion strukturave përkatëse doganore dhe tatimore, lidhur me situatën e tatimpaguesit, sipas dokumentacionit:"

2. Në pikën 133, pas pikës 3, shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

"4. Për të gjitha shkeljet që ndodhin në periudhat pas hyrjes me fuqi të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, pavarësisht nga momenti i konstatimit, do të aplikohen dënimet administrative në fuqi në momentin e kryerjes së shkeljes."

Në pikën 106 "Objekti i ankimit administrativ tatimor", paragrafi 106.4.2. ndryshohet me këtë përmbajtje.

"106.4.2. Drejtoria e Apelimit Tatimor i dërgon një kopje të ankimit me postë apo në formë elektronike organit të administratës tatimore që ka nxjerrë ose nuk ka nxjerrë aktin administrativ në fjalë".

Në pikën 107 "Pagesa e tatimit objekt ankimi administrativ tatimor" paragrafi 107.3.2 ndryshohet me këtë përmbajtje.

"107.3.2. Në qoftë se tatimpaguesi bën ankim kundër një detyrimi tatimor dhe në të njëjtën kohë ka paraqitur një kërkesë për kompensim detyrimi (nëpërmjet së cilës ka argumentuar kompensimin e detyrimit tatimor që ankimohet me tatime të paguara tepër apo tepërcë kreditore nga periudha të mëparshme), në zbatim të neneve 75 dhe 107 të ligjit, Drejtoria Rajonale Tatimore është e detyruar që brenda një periudhe jo më shumë se 15 ditë kalendarike, t'i konfirmojë me shkrim tatimpaguesit për kompensimin e detyrimit objekt apelimi ose per moskryerjen e kompensimit.

Në pikën 108 "Veprimet e ndërmarra nga Drejtoria e Apelimit Tatimor lidhur me ankimin", paragrafi 108.4 ndryshohet me këtë përmbajtje.

"108.4. Ankimuesi ka të drejtë nese e kërkon, të paraqitet vetë ose me përfaqësues në Drejtorinë e Apelimit Tatimor për të dhënë argumente dhe sqarime që ndihmojnë në trajtimin dhe zgjidhjen e drejtë të akimimit."

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode